

INSTITUTI I KONTABILISTEVE TE MIRATUAR

RREGULLORE E BRENDSHME E FUNKSIONIMIT TE KESHILLIT TE DREJTIMIT

Bazuar ne dispozitat e Statutit te IKM, neni 16, hartohet Rregullorja e Brendshme si vijon:

Neni 1

KESHILLI I DREJTIMIT DETYRAT DHE KOMPENTECAT

Eshte pergjegjegjes per drejtimin e puneve te IKM ne periudhat midis dy mbledhejve te njepasnjeshme te asamblesë ne perputhje me Aktet Ligjore e nenligjore ne fuqi, Statutin dhe me Vendimet e Asamblese se Pergjithshme IKM.

Detyrat e Keshillit te Drejtimit jane:

a- Siguron funksionimin e rregullt te IKM dhe organizon dhe ndjek veprimtarine e Degeve dhe Seksioneve ne rrethe, koordinimin e veprimtarise se organeve te saj, shtimin e antareve dhe shtrirjen e veprimtarise ne te gjithë rrethet, ne rrethet me numur te mjaftueshem antaresh ose ne grup rreth organizon krijimin e Degeve ose Seksioneve,

b- Organizon veprimtarine e Degeve e Seksioneve ne rrethe, zgjedhjen e organeve drejtuese dhe nepermjet Struktures Ekzekutive ndjek veprimtarine e organeve drejtuese ne Dege e Seksione.

Merr pjese ne mbledhjet per zgjedhjen e organit drejtues ne Rrethe (Dege dhe Seksion) ne analizat vjetore si dhe kur kerkohet nga Drejtuesi i Deges ose shumica e anetareve. Në këto mbledhje KD perfaqesohet nga nje anetar i tij.

c- Organizon punen per te siguruar mbrojtjen e profesionit.

Ndjek respektimin e rregullave te etikes profesionale te veprimtarise ben plotesimin e tyre, vendos per ceshtje ne dobi te profesionit.

e- Merr masat e nevojshme parandaluese te akteve qe çvleresojne profesionin, duke marre masat perkatese ose sanksione, pavaresisht nga gjykimi civil ose penal,

f- Harton Rregulloren e brendeshme dhe Organigramen e IKM, te Struktures ekzekutive, Rregulloren e funksionimit te Keshillit te Degeve te Seksioneve, Rregulloren e funksionimit te organeve drejtuese te Degeve te Seksioneve.

g- Siguron administrimin e pasurise se IKM nepemrjet ngritjes se rregulave te kontrollit te brendshem dhe te Kontabilitetit.

h- Pergatit Buxhetin e IKM ndjek zbatimin e tij. I raporton Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e buxhetit dhe per llogarite vjetore te IKM.

i- Perfaqeson IKM prane organeve shteterore, te drejtesise dhe ne te trete,

j- Organizon kualifikimin e vijueshem profesional te anetareve te IKM si dhe zhvillimin e kurseve profesionale dhe te provimeve te aftesis profesionale te kandidateve per Kontabilistë te Miratuar. Kur e lejojne dispozitat ligjore organizon provimin dhe leshon Dëshmin e “Kontabilist i Miratuar”. Organizon kurset e kualifikimit dhe procesin e provimeve per certifikata apo deshmi profesionale te ndryshme ne fushen e kontabilitetit, tatimeve, audimimit, etj te ngjashme. Bashkepunon me Ministrine e Financave, Keshillin Kombetar te Kontabilitetit, institucione e organizma te tjera per probleme te kontabilitetit te legjislacionit, kualifikimit te anetareve etj.

k- Vendos per ndarjen e detyrave midis anetareve te Keshillit bazuar ne kete rregullore, ne Statutin e IKM ne mbledhjen e pare te Keshillit Drejtues mbas zgjedhjeve nga Asamblea e Pergjithshme.

Gjate zhvillimit te veprimtarise mund te vendose per caktimin e detyrave te reja ose ndryshimeve te nevojshme ne detyrat e caktuara.

m- Vendos krijimin e komisioneve te punes prane Keshillit Drejtues, miraton programet e punes te hartuara perj tyre dhe ndjek zbatimin e detyrave te programuara.

n- Vendos per pagat e shperblimet sipas kompetencave te caktuara ne Statutin e IKM.

NENI 2

2.1 PERBERJA E KESHILLIT TE DREJTIMIT

Anetaret e Keshillit te Drejtimit zgjidhen nga Asamblea e Pergjithshme me nje mandat prej kater vjetesh dhe jo me teper se 2 mandate radhazi.

2.1.a PRESIDENTI

-Drejton punen e Keshillit te Drejtimit dhe te Keshillit te zgjeruar te kryetareve te Degeve e Seksioneve e objektiveve te IKM ne mbrojtje te profesionit, kualifikimit profesional, zbatimin e Kodit te Etikes profesionale, te rregullave profesionale, menjanimit te konkuresces se pa ndershme pergatitjen dhe zbatimin e Buxhetit, bashkepunimin me Ministrine e Financave dhe institucione e organizma profesionale Brenda dhe jashte vendit etj.

-Kryeson mbledhjet e Keshillit te Drejtimit, mbledhjen e KZKDS, dhe mbledhjen e asamblese te antareve te IKM. Therret mbledhjet e KD, KZKDS si dhe asamblene e antareve sipas parashikimeve te bera ne statut.

-Ne marreveshje me anetaret e keshillit cakton detyrat per secilin antar te Keshillit te Drejtimit.

-Perfaqeson IKM ne marrevedhenje me te tretet, nenshkruan te gjitha dokumentet qe dalin nga IKM; ne mungese te tij autorizon te nenshkruaje Zv.Presidentin.

-Nepermjet Struktures Ekzekutive ndjek zbatimin e Vendimeve te Asamblese Pergjithshme, te Programeve te miratuara nga asambleja dhe KD,, te Statutit dhe te dispozitave ligjore ne fuqi.

Shqyrton propozime e probleme profesionale ose per dispozita ligjore, qe paraqiten nga deget e seksionet ose anetare te IKM. Sipas rastit, mund t'i diskutoje me anetare te keshillit ose i paraqit ne Keshillin e drejtimit per t'i dhene rruge zgjidhje

-Ndjek zbatimin e detyrave nga antaret e Keshillit te Drejtimit, Komisioneve prane Keshillit te Drejtimit Kryetareve te Degeve, Komitetit te kontrollit te brendshem, Komitetit te Kontrollit te Cilesise, nga struktura ekzekutive.

Presidenti firmos të gjitha vendimet e mbledhjeve të KD si dhe të asamblesë të antarëve

2.1.b Zv. PRESIDENTI

-Bashkepunon me Presidentin per zbatimin e objektivave te IKM dhe te detyrave te tjera.

-Zevendeson Presidentin ne mungese te tij, nenshkruan dokumente, perfaqeson IKM me autorizimin te Presidentit.

-Së bashku me presidentin drejton punen per mbrojtjen e profesionit, hartimin dhe zbatimin e Kodit te Etikes profesionale te Standarteve profesionale, per studime ne fushen e kontabilitetit, te dispozitave ligjore e tatimore, etj.

-Shqyrton propozime e probleme profesionale ose per dispozita ligjore, qe paraqiten nga deget e seksionet ose anetare te IKM. Sipas rastit, mund t'i diskutoje me anetare te keshillit ose i paraqit ne Keshillin e drejtimit per t'i dhene rruge zgjidhje.

2.1.c ANTARI I KESHILLIT

-Secili prej antarëve te keshillit eshte pergjegjës per te organizuar dhe kryer punen e ngarkaur nga KD, ne perputhje me komisionin ku merr pjese.

Organizon dhe drejton cdo veprimtari ne perputhje me detyrat e lena nga KD apo asamblea e antaresise. Merr pjese ne mbledhjet e degeve dhe seksioneve te IKM ne rastet e caktuara nga KD si dhe perfaqeson KD ne keto mbledhje. Raporton në lidhje me ecurine e mbledhjeve tek KD.

Bashkepunon me antaret e tjere, me strukturen ekzekutive dhe me drejtuesit e Degeve e seksioneve per ceshtje te ndryshme te ngarkuara nga KD.

-Bashkepunon me Institucione e organizma te tjera kur eshte i ngarkaur per te perfaqesuar IKM ose ne rolin e antarit te komisioneve te ngritura pranë IKM.

Merr pjese ne mbledhjet e KD te IKM te therritura nga kryetari i KD dhe luan rol aktiv ne trajtimin dhe mbarevajtjen e ketyre mbledhjeve dhe te ceshtjeve te trajtuar ne to.

Mbeshtetin KD dhe strukturat ekzekutive per nje zhvillim te aktivitetet te tyre ne perputhjem me kerkesat e statutit dhe kereksat e etikes profesionale te IKM

3. FUNKSIONIMI I KESHILLIT TE DREJTIMIT DHE VENDIMMARRJA

Keshilli i Drejtimit si rregull mbledhet nje here ne dy muaj . Mbledhjet e Keshillit therriten dhe kryesohen nga Presidenti ose ne mungese te tij, nga Zv Presidenti.

Keshilli i Drejtimit mund te marre vendime kur jane te pranishem jo me pak se 2/3 e anetareve. Vendimet merren me shumice absolute votash te anetareve te pranishem. Ne rast votash te barabarta, vota e Kryetarit, ose ne mungese te tij, e zevendes Kryetarit, eshte percaktuese.

Antareve te KD mund tu revokohete mandati, në rast vdekje, doreheqje ose cdo rasti tjetër te pengimit te anetareve te Keshillit te Drejtimit. Nje antar i KD i revokohet mandati nese nuk merr pjese 3 here rradhazi ne mbledhjet e KD, kur ka vendim gjykate qe nuk lejohet te ushtrojë profesionin apo i hiqet liria. Po ashtu KD mund ti propozoje Asamblese heqjen e madatit te nje antari te KD nese ka konstatuar shkelje te renda e te perseritura te kryera nga antari ne dem te interesave te IKM dhe ne kundërshtim me interesat e IKM.

Ne rast revokimi, vdekje, doreheqje ose cdo rasti tjetër te pengimit te anetareve te Keshillit te Drejtimit, Asamblea e Pergjithshme mund te kooptoje, deri ne kryerjen e zgjedhjeve te ardhshme, nje antar tjetër, nga kandidatet qe ne zgjedhjet e meparshme ka fituar numurin me te madh te votave, por nuk ka qene zgjedhur antar i Keshillit te Drejtimit.

Bazuar ne sa siper Keshilli i Drejtimit, brenda nje muaji nga data e largimit te nje anetari te Keshillit, vendos caktimin provizor te kandidatit deri ne daten e mbledhjes se Asamblese se pergjithshme.

Numuri i anetareve te kooptuar nuk mund te jete me shume se dy. Ne qofte se krijohen me shume se dy vende vakant, atehere Asambleja e Pergjithshme duhet te mbledhet, per te zgjedhur aq anetare sa mungojne, perfshire edhe anaret e kooptuar. Anaret e rinj te zgjedhur perfundojne mandatin e anetareve qe kane zevendesuar.

Heqja e mandatit të një antari të KD bëhet me kërkesë të kryetarit, te 2 antareve ose te nje kryesie te degeve apo seksioni te rretheve. Ne rast heqje mandate, pervec vdekjes, vendimi duhet te miratohet nga asamblea e pergjithshme e rradhes.

Kjo rregullore hyn në fuqi duke filluar nga data 01 Shkurt 2007

Kryetari i Keshillit te Drejtimit

Prof.Dr. Sotiraq DHAMO